



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

Në bazë të nenit 44 dhe 48 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 28 dhe 29 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 13.12.2024, miraton këtë:

V E N D I M PËR KUNDËRSHTIMIN E NDËRTIMIT TË DEPONISË SANITARE

I. Me këtë Vendim, kërkohet anulimi i pikës tre (3) të paragrafit 1 të Vendimit Nr.33/178 të datës 13.12.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës në zonat kadastrale: Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë.

A r s y e t i m

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën, 13.12.2024 kanë diskutuar lidhur me Vendimin Nr.33/178 të datës 13.12.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme në ZK Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë, me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.

Ndërtimi i “Deponisë Sanitare” në zonat e caktuara kadastrale dhe në afërsi të vendbanimeve Ribar i Madh, Poturoc, Qylagë, Vërshec dhe Zllakuqan, do të ketë ndikim të theksuar mjedisor, duke përfshirë edhe ndikimin në shëndetin dhe cilësinë e jetës së banorëve.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, vlerësojnë se kjo hapësirë nuk është e përshtatshme për ndërtim të Deponisë Sanitare dhe për planifikimin e asaj zone nuk janë plotësuar një mori kriteresh ligjore dhe mjedisore sipas legjislacionit në fuqi.

Komuna e Lipjanit, po ashtu ka pranuar reagime dhe shqetësime të shumta të banorëve të asaj zone, sidomos të fshatrave Ribar i Madh, Poturoc, Qylagë, Vërshec dhe Zllakuqan lidhur me ndërtimin eventual Depinisë Sanitare.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës vlerësojnë se këto shqetësime janë të bazuara, duke pasur parasysh ndikimin e Deponisë sanitare në shëndetin dhe jeten e tyre.

Duke u bazuar në rrethanat e sipërshënuara, kërkojmë nga Anëtarët e Kuvendit të aprovohet ky propozim Vendim.

Ky Vendim i dërgohet:

Qeverisë së Republikës së Kosovës;
Kryetarit të Komunës; dhe
Arkivit të Komunës.

Nr. 15-352/01-61839

Lipjan, më 13.12.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

